

BULETINI INFORMATIV

KORRIK

2025



Vendimmarrjet e Bordit të ERE gjatë muajit korrik

Gjatë muajit korrik 2025, Bordi i ERE zhvilloi 5 mbledhje vendimmarrëse, ku u shqyrtuan dhe miratuan 40 vendime në funksion të zhvillimit dhe rregullimit së tregut të energjisë.

Licencime të reja

Shoqëria "SPV BLUE 2" shpk u licencua nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) për veprimtarinë e veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar për secillin aktivitet; shoqëria "GRABOVA HYDROPOWER" sh.p.k. u licencua në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga Hec "Grabova", me kapacitet të instaluar 14.9 MW, me vendndodhje në pellgun ujë mbledhës të përroit të Grabovës, degë e lumit të Devollit, Qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar. Sipas kushteve të vendimit të licensimit ky subjekt duhet të fillojë operimin për prodhimin e energjisë elektrike brenda datës 15.05.2027; si dhe shoqëria "EZ-5 ENERGY" sh.p.k. u licencua po ashtu në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 30MW për një afat 30-vjeçar, në Qarkun Fier. Ky impiant është planifikuar të fillojë operimin brenda datës 31.12.2025.

U miratuan ndryshimet në Vendimet nr. 258, datë 21.12.2021, "Mbi licensimin e shoqërisë "YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe nr. 199, datë 03.08.2022, "Mbi licensimin e shoqërisë "NRG POWER" sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike" duke shfuqizuar disa nga kushtet e vendosura me herët si rezultat i plotësimit të dokumentacionit/informacionit të kërkuar.=

Procedura të filluara gjatë muajit korrik

Gjatë muajit korrik, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) filloi procedurat për licensimin e shoqërive:

- "POWER ENERGY" shpk në veprimtarinë e tregtimit dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 25 MW me vendndodhje fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmernas, Bashkia Fier.
- "KËLCYRA 2020" shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Klisyrë", me kapacitet prodhues 2 MW, me vendndodhje në Klisyrë, Tropojë.
- "GLOBAL TECHNICAL MECHANICS" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centralit gjenerues fotovoltaik me kapacitet prodhues 12MW dhe veprave ndihmëse, me vendndodhje në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqen, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, për një afat 25-vjeçar.

Në përputhje me "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, ERE për të gjitha këto aplikime vijoi me publikimin në median e shkruar, në faqen zyrtare www.ere.gov.al si dhe në rrjetet sociale Facebook dhe LinkedIn për marrjen e objeksioneve para vendimarrjes respektive të licensimit ose jo.

Vendime të tjera

U miratua masa administrative e heqjes së licencës ndaj shoqërive debitore "ENERGIA GAS AND POWER ALBANIA" shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike si dhe "ENERGY SUPPLY-AL" shpk në veprimtarinë e furnizimit dhe të tregtimit të energjisë elektrike.

U rishikuan vendimet respektive të licensimit për aktivitetet e prodhimit për subjektet "NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k, dhe pjesërisht nga "H.K HEC GRABOVA 2" sh.p.k, në vijim të konstatimit të përmbushjes së kushteve nga "NOVA SOLAR SYSTEM" sh.p.k, dhe pjesërisht nga "H.K HEC GRABOVA 2" sh.p.k.



www.ere.gov.al



+355 45 620 820

+355 45 620 821

BULETINI INFORMATIV

KORRIK

2025

- U miratua ndryshimi i pikës 2 në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.04.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “SOLAR HORIZON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 MW”, duke përcaktuar datën 05.11.2025 afatin e fundit për të filluar ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.
- Vendimi i Bordit të ERE nr. 51, datë 03.03.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “DELIU 3D” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shiroku”, me kapacitet të instaluar 1,6 MW” duke përcaktuar datën 31.01.2026 si afati brenda të cilit kjo shoqëri duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shiroku”.

Po ashtu u rishikuan:

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr.107, datë 23.05.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “DELIU 3D” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve” duke shfuqizuar një nga kushtet e paracaktuara pas konstatimit të plotësimit të dokumentacionit të kërkuar sipas pikës 3 të këtij vendimi.
- Vendimet e Bordit të ERE-s nr. 191, datë 06.06.2023, dhe nr.147, datë 24.04.2023, “Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve të paluajtshme të centralit fotovoltaik BLUE 1 në favor të Green for Growth Fund Southeast Europe S.A, SICAV-SIF” si dhe mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV BLUE 1” si mjet (Barrë siguroese) për garantimin e detyrimit ndaj Green for Growth Fund Southeast Europe S.A, SICAV-SIF”. Në mbledhjen e datës 31.7.2025 u miratua dhënia e autorizimit për vendosjen e një barre të re siguroese mbi asetet fikse dhe kuotat të centralit fotovoltaik ‘Blue 1’, në favor të “Fibank Albania” sh.a. dhe “First Investment Bank AD” (Bullgari), në kuadër të marrëveshjes të huasë, për qëllime rifinancimi.

Vendime të tjera

U pranua kërkesa e shoqërisë “SunPro” shpk për pezullimin e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali eolik, me kapacitet prodhues 3 MW për të plotësuar dokumentacionin e plotë dhe të përditësuar që i mungon, deri më datë 30.09.2025, si dhe **zgjatja** me 30 ditë e afatit të vendimmarrjes për kërkesën e shoqërisë “Energovia.Albania” shpk për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, periudhe gjate të cilës shoqëri duhet që të depozitojë dokumentacionin e munguar. **Po ashtu u pezullua** vendimmarrja e Bordit të ERE-s për kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 8.8 MW, me vendndodhje Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, me kërkesë të subjektit

Vendime për çmimet dhe tarifat

Në mbledhjen e datës 8 korrik, Bordi miratoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2025 prej 13.97 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

Regjistri Remit

Pjesëmarrësit e tregut që regjistrohen pranë OST sha, për të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike, po ashtu regjistrohen dhe në regjistrin REMIT, sipas “Rregullores për integritetin dhe transparencën e tregut me shumicë të energjisë (REMIT)”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 126, datë 17.05.2021. Ky regjistër gjendet i publikuar dhe i përditësuar më datë 31.07.2025 në faqen e ERE-s në linkun <https://ere.gov.al/sq/tregu-i-energji-se/remit>.

Autorizime për garanci financiare

Bordi i ERE-s miratoi kërkesat e disa shoqërive në lidhje me **marrjen e autorizimit për barrësimin e kuotave dhe vendosjen apo transferimin e aseteve fikse** (nëpërmjet hipotekës dhe/ose marrëveshjes siguroese), si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimeve ndaj të tretëve, për qëllim të financimit të ndërtimit të impianteve prodhuese të energjisë elektrike. Në këtë kuadër u miratuan autorizime për shoqëritë:

“ZENINA” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit nr. 25, Datë 27.01.2025 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 30-vjeçar.

“SLR ALBANIA” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit nr. 262, datë 02.12.2024 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar.

“NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit nr. 242, datë 03.08.2023, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet 50 MW.

“CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 306, datë 30.11.2022 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 MW, për një afat 25-vjeçar.

“DIMAX ALBANIA” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 308, datë 30.11.2022 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 MW, për një afat 25-vjeçar.

“ARIS ALBANIA” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 55, datë 22.02.2021 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet disa HEC-eve, me kapacitet total të instaluar 4755 kW, për një afat 30 vjeçar.

“HYDROPOWER” sh.p.k. licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 307, datë 30.11.2022 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhimi 2 MW, për një afat 25-vjeçar.

Gjithashtu u miratuan kërkesat e shoqërive të mëposhtme:

1. **“ARIS ALBANIA” sh.p.k** për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë.
2. **“HYDROPOWER” sh.p.k** për përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 101, datë 12.05.2025 mbi “Fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së hipotekës) të aseteve fikse të saj.

BULETINI INFORMATIV

KORRIK

2025

Seanca dëgjimore me palët e interesit

Gjatë muajit korrik, ERE organizoi 9 seanca dëgjimore me konsumatorë, subjekte të licencuara si dhe akte rregullatore në shqyrtim. Çështjet e adresuara përfshinin:

Zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet konsumatorëve dhe operatorëve (FSHU sh.a., OSSH sh.a.) me qëllim sqarimin e problematikave që lidhen kryesisht me:

- Mbifaturimin - keqfaturimin e energjisë elektrike;
- Fiktivitetin e një kontrate;
- Faturimin si rezultat i testimit të matjes;
- Faturimin me dëm ekonomik.

Sqarime me subjekte të licencuara në lidhje me aplikimet e tyre për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e barrës siguruese mbi kuotat e shoqërive.

Diskutime me palët e interesit, përkatësisht përfaqësuesit e Shoqatës "Zharrëza", z. Lavdosha Ferruni (Shoqata e Bujqësisë Organike dhe Mjedisit), përfaqësues të shoqërisë "Fier Thermoelectric" sha, të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Drejtorisë Rajonale të Mjedisit Fier dhe të OST sha, në lidhje me objeksionet/komentet e paraqitura nga shoqatat ambientaliste të përmendura më sipër, mbi aplikimin e shoqërisë "Fier Thermoelectric" sha për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Palëve iu bë me dije se ERE do të marrë vendimin përfundimtar mbi aplikimin e shoqërisë, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi, dokumentacionin e dorëzuar dhe komentet/objeksionet e paraqitura.

Filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së OST sha. për miratimin e "Një Udhëzuesi mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike".



www.ere.gov.al



+355 45 620 820

+355 45 620 821

Si dhe u miratuan:

-Disa shtesa dhe ndryshime në kontratën tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe furnizuesi i shërbimit universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që

furnizohen nga FSHU sh.a.". Këto ndryshime vijnë si rezultat i përditësimit të referencave ligjore dhe nënligjore në kontratë, zhvillimeve në liberalizimin e tregut të energjisë elektrike dhe referencave në aktet që përcaktojnë çmimet e shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga FSHU përfshirë klientët me status të veçantë.

-Dokumenti i përbashkët i tre Rregullatorëve të Energjisë, ERE, RAAEY dhe ARERA: "Miratimi i një ndryshimi të "Kodit të Rrjetit TAP", propozuar nga TAP AG më 12 maj 2025.

-“UDHËZIMET PËR TESTIN E TREGUT TË GAZSJELLËSIT TRANS ADRIATIK 2025”, paraqitur nga TAP AG.

-Kërkesa e TAP AG për moszbatimin e standardit ISO/IEC 27001, dhe klasifikimin si subjekt në kuadër të zbatimit të Direktivës NIS2 sipas Rregullores për Sigurinë Kibernetike të Infrastrukturës Kritike në Sektorin e Energjisë.

-“Propozimi i Projektit nga TAP, SRG dhe DESFA për procesin e Rritjes së Kapacitetit të vitit 2023 - Faza e Lidhjes”, objekt i miratimit gjithashtu nga rregullatorët e Italisë dhe të Greqisë, (ARERA dhe RAAEY).

Gjithashtu, në wefaqen e ERE-s do të gjeni të rifreskuar:

-Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në Programin e Transparencës;

-Regjistrin e ankesave të konsumatorit;

-Regjistrin e licencimeve;

-Regjistrin e autorizimeve;

-Regjistrin e vendimeve 2025;

-Çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për vitin 2025.

Në datën 11.07.2025 në faqen e ERE-s u publikua për konsultim publik dokumenti “Për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike” në kuadër të transpozimit të legjislacionit të Komunitetit të Energjisë, komentet për të cilin priten deri më datë 04.09.2025.